

COVID-19 PËRMBLEDHJE E UDHËZIMEVE #2

Masat e marra dhe këshillimi i pacientëve nga farmacistë e rrjetit të hapur

1. Në shumë shtete, marrja e infektionit nga komuniteti është mënyra primare e përhapjes së sëmundjes. Ndërkohë që historia e udhëtimeve në zonat e prekura vazhdon të jetë një nga kriteret më të rëndësishme në vlerësim në vendet me pak raste ose në një fazë fillestare të shpërthimit, nuk mund të jetë më një kriter relevant në vendet me transmetim në komunitet lokalisht.
2. Për aq kohë sa infektimi mund të ndodhë nga individë asimptomatik ose presimptomatik, përkujdesjet rekomandohen për të gjithë klientët dhe pacientët që hyjnë në farmaci.

KRITERET	NDËRHYRJE
<ul style="list-style-type: none">• Pa simptoma (kollë, ethe ose problem me frymëmarrjen)• DHE• Asnjë kontakt i kohëve të fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara me COVID-19 dhe asnjë histori aktuale udhëtimi në ndonjë nga vëndet e prekura	<ul style="list-style-type: none">• Ofroni siguri• Theksoni masat parandaluese• Rekomandoni distancim social, izolimin në shtëpi, shmangjen e udhëtimeve të cilat nuk janë të domosdoshme (vendase apo ndërkombëtare) kur është e mundur.• Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)
<ul style="list-style-type: none">• Me simptoma (kollë, ethe ose probleme me frymëmarrjen)• DHE• Asnjë kontakt i kohëve të fundit me raste të konfirmuara ose të dyshuara me COVID-19 dhe asnjë histori aktuale udhëtimi në ndonjë nga vëndet e prekura.	<ul style="list-style-type: none">• Ofroni siguri• Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë• Kur është e mundur, izoloni pacientin në një dhomë të veçantë.• Mos e vizitoni fizikisht pacientin• Forconi masat vetëmbrojtëse, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm, doreza dhe syze• Theksoni masat për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm, përfshirë përdorimin e një maskë për fytyrën nga pacienti• Rekomandoni distancë të rreptë sociale (përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinimin në shtëpi dhe shmangjen e të gjithë udhëtimeve (vendase dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë• Për individët e grupeve me rrezik më të lartë, këshilloni që të kontaktojnë numrin e emergjencës ose institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor për testimin dhe kujdesin vijues dhe trajtimin.• Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)
<ul style="list-style-type: none">• Pa simptoma (kollë, ethe ose problem me frymëmarrjen)• DHE• Dihet se ka kontakt të kohëve të fundit me raste të konfirmuara me infektionin e COVID-19 dhe/ose histori aktuale udhëtimi në një zone të prekur	<ul style="list-style-type: none">• Ofroni siguri• Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë• Rekomandoni distancë të rreptë sociale (përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinën në shtëpi dhe shmangjen e të gjithë udhëtimeve (vendase dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë• Rekomandoni gjurmimin e historisë së kontakteve• Në rast se simptomat shfaqen në 14 ditët pas kontaktit me rastin e konfirmuar ose të dyshuar, kontaktoni numrin e urgjencës dhe ndiqni udhëzimet e duhura• Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)
<ul style="list-style-type: none">• Me simptoma (kollë, ethe ose probleme me frymëmarrjen)• DHE• Dihet se ka kontakt të kohëve të fundit me raste të konfirmuara me infektionin e COVID-19 dhe/ose histori aktuale udhëtimi në një zone të prekur	<ul style="list-style-type: none">• Ofroni siguri• Informoni që rreziku i COVID-19 mund të ekzistojë• Kur është e mundur, izoloni pacientin në një dhomë të veçantë.• Mos e vizitoni fizikisht pacientin• Forconi masat vetëmbrojtëse, përfshirë përdorimin e një respiratori të përshtatshëm, doreza dhe syze• Theksoni masat për të parandaluar transmetimin e mëtejshëm, përfshirë përdorimin e një maskë për fytyrën nga pacienti• Rekomandoni distancë të rreptë (përfshirë familjen dhe marrëdhëniet e ngushta), karantinën në shtëpi dhe shmangjen e të gjithë udhëtimeve (vendase dhe ndërkombëtare) për të paktën 14 ditë• Për individët e grupeve me rrezik më të lartë, këshilloni të kontaktoni numrin e emergjencës ose institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor për testimin dhe kujdesin vijues dhe trajtimin.• Siguroni informacione dhe këshilla të bazuara në prova (me goje dhe/ ose me shkrim)• Dezinfektoni çdo zonë dhe sipërfaqe të kontaminuar

Ky dokument është përkthyer nga anglishtja nga Orion JUCJA, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë. Në rast të ndonjë divergjence midis dy teksteve, dokumenti origjinal i Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike në anglisht prevalon. E drejta e autorit mbetet ajo e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike.

Për detaje dhe referenca mbështetëse, konsultohuni me dokumentin e plotë udhëzues në www.fip.org/coronavirus

Ky dokument bazohet në provat dhe rekomandimet në dispozicion të organizatave me reputacion në kohën e publikimit. Ai do të përditësohet kur njohuritë e reja bëhen të disponueshme. 26 Mars 2020.

